

## **KLSH prezanton gjetjet e auditimit të performancës “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”**

Departamenti i Auditimit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit prezantoi në një takim me ekspertë të fushës gjetjet dhe rekomandimet e raportit të auditimit të performancës “*Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit*”.

Aktiviteti u zhvillua në mjediset e KLSH-së në datën 25.10.2023 me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të KLSH-së, znj. Marjola Llanaj, drejtuesit të Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, Prof. Dr. Besnik Baraj, auditues dhe përfaqësues nga shoqëria civile të angazhuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit, znj. Valbona Mazreku.

Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Marjola Llanaj vlerësoi punën e Departamentit të Performancës, i cili ka pasur një larmi temash audituese të orientuara drejt shërbimeve të qytetarëve dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës.

*“Gjeneza e të gjitha problemeve shëndetësore në popullatë është ndotja e ajrit. Rezultatet e auditimeve të tilla janë një alert shumë i mirë për vendimmarrësit e politikave”,* - u shpreh Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së.

Znj. Llanaj falënderoi pjesëmarrësit në takim, duke theksuar se institucioni është i hapur për çdo bashkëpunëtor shkencor apo qytetar.



Drejtuesi i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi theksoi se përmes këtij auditimi, KLSH ka dhënë kontribute në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve, si detyrë e rëndësishme që ndihmon në mirëqenien e të gjithëve.

*“Politikat e transportit kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në përmirësimin e ndotjes së ajrit. KLSH, bazuar në gjetjet ka dhënë disa rekomandime për përmirësimin e situatës si dhe ka përcjellë mesazhin kryesor të këtij auditimi: të nxitet rinovimi i flotës së mjeteve rrugore me emetim të ulët të ndotësve si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit”, - tha z. Zylfi.*

Gjetjet e auditimit *“Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”* janë prezantuar nga kryeaudituesi Aulent Guri.

Nga auditimit ka rezultuar se:

- Flota e mjeteve të transportit rrugor nuk ka pësuar ndryshime pozitive në drejtim të uljes së moshës mesatare të mjeteve rrugore si dhe të përdorimit të karburanteve me ndikim të ulët në cilësinë e ajrit.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE) së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) nuk kanë garantuar të dhëna të besueshme dhe të mjaftueshme për vlerësimin e gjendjes reale të cilësisë së ajrit.
- Qeveria shqiptare, krahas mos transpozimit të disa direktivave të rëndësishme për nxitjen dhe përdorimin e mjeteve me karburant alternativ, nuk ka specifikuar objektiva, aktivitete dhe targete të matshme e të arritshme në dokumentet e saj strategjike.
- MTM dhe MIE, krahas mos monitorimit dhe raportimit mbi zbatimin e akteve ligjore/nënligjore, nuk kanë hartuar Programin Kombëtar të Pakësimeve të Shkarkimeve në Ajër si dhe nuk kanë përcaktuar Angazhimet Kombëtare për pakësimin e shkarkimeve.
- Ka munguar bashkëpunimi ndërinstitucional (midis MTM dhe MIE) për promovimin dhe mbështetjen financiare të masave me qëllim pakësimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Nisur nga të dhënat kontradiktore të flotës së mjeteve rrugore M1 (kategoria mjedisore Euro 3) për periudhën 2019-2022, nuk mund të arrihet në një vlerësim objektiv mbi zbatimin e VKM nr. 633. 2018 *“Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”*.
- Pavarësisht lehtësirave fiskale që aplikohen në vendin tonë, kanë munguar subvencione të mirëfillta për të nxitur shtimin e numrit të mjeteve rrugore ekologjike.

Në këtë aktivitet, Prof. Dr. Besnik Baraj prezantoi studimin e tij “Gjendja e ndotjes së ajrit në Tiranë, lidhja me shëndetin dhe Covid-19”.

*“Ekziston një lidhje e ngushtë mes ndotjes së ajrit dhe përhapjes së sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në popullatë. Vlerësoj shumë sensibilitetin e KLSH-së për problematikën mjedisore, që është e lidhur direkt me njerëzit, por që ndjeshmëria është shumë e ulët nga politikëbërësit”, theksoi Prof. Dr. Besnik Baraj.*



Auditimi “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit” është realizuar në bashkëpunim me ekspertët e SAI-t të Norvegjisë.